



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Haki Rugova , Kryetar i Komunës së Istogut Qaush Balaj, Kryesues i kuvendit të Komunës së Istogut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Z.v. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 22/06/2021 Nr.43-510/1
Zyrtari përgjegjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave.	
Komisioni ndërministror për hartimin dhe vlerësimin e aktit	Sanije Dërguti, MAPL Sabrie Rama, MMPHI Ardian Mehmeti, MD	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Istogut	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullorja komunale Nr.2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba
E miratuar më datë: 31.05.2021
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.06.2021

Komisioni Nderministror i formuar nga MAPL, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
	Rregullore Nr.2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba	<p>Rregullore Nr.2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba , e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut, është shqyrtuar nga ministritë përkatëse, e të cilat pas vlersimit kanë konstatuar se rregullorja është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi si vijon:</p> <p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktues:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Komuna e Istogut nuk i ka aplikuar rekomandimet e dhëna sa i përket taksës për Leje Ndërtimore. •Tarifat për taksën për shërbim te mbeturinave nuk është e përfshirë në këtë rregullore dmth dispozitat e Rregullores në fjalë nuk shqyrtojnë taksat për shërbimet për mbledhjen e mbeturinave. •Neni 12, (Gjobat) të Rregullores në fjalë, ku është specifikuar legjislacioni për shqiptimin e gjobave, vlerësojmë se nga aspekti shkeljeve për mjedisin nuk është e mjaftuar që të specifikohet vetëm Udhëzimi Administrativ Nr.06/2018, për gjoba mandatore, sepse ekzistojnë edhe shume ligje dhe akte nënligjore tjera për mbrojtjen e mjedisit për të shqiptuar, kur është e nevojshme. •Komuna e Istogut nuk i ka aplikuar rekomandimet sa i përket tarifave për shërbimet dhe produktet kadastrale.

Bazuar në të cekurat më lartë, Komisioni Nderministror i formuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Istogut që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.